



Vlerësimi i Organizatave Jo- Fitimprurëse në Bashkinë e Kukësit, me qëllim rritjen e Vizibilitetit dhe Mirëmenaxhimin Mjedisor

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)
Qershor, 2021

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive.....	3
1. Prezantimi i shkurtër i projektit.....	4
2. Pamje e përgjithshme e kuadrit rregullator dhe ligjor në Shqipëri.....	5
2.1. Kuadri ligjor	7
2.2 Analiza SWOT për sektorin e ujit në Kukës.....	7
2.3 Roli i OJF-ve në mirëqeverisje	8
2.4 Pengesat dhe Mundësitë.....	10
3. Metodologji e Studimit	12
3.1 Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	12
3.2 Dizajni i Studimit.....	12
3.2.1 Kampionimi i studimit dhe mbledhja e të dhënave.....	13
3.2.2 Analiza e të dhënave	14
3.3 Limitet e studimit.....	14
4. Gjetjet e Studimit	15
4.1 Vlerësimi i kapaciteteve të OJF	15
4.2 Vlerësimi i kapaciteteve të OJF-ve në bashkinë Kukës.....	16
4.3 Ndërtimi i kapaciteteve të brendshme dhe të jashtme të OJF-ve.....	16
4.2 Impakti dhe arritjet e OJF.....	18
4.3 Mësimet e nxjerra.....	19
5. Konkluzionet dhe Rekomandimet	23
Bibliografia.....	26
Shtojca 2: Lista e OJF Kukës.....	27
Shtojca 3: Instrumenti vetëvlerësues	29

Lista e Tabelave

Tabela 1. Analiza SWOT për sektorin e ujit në Bashkinë Kukës.....	8
Tabela 2. Numri i kampionit të përfshirë në studim	13
Tabela 3. Shembuj aktiviteteve për të rritur kapacitetet	17

Përmbledhje Ekzekutive

Organizatat Jo Fitimprurëse promovojnë krijimin grupimeve të ndryshme të interesit për të adresuar çështjet në mënyrë që të krijohen ura komunikimi dhe për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme. Ky studim ka si qëllim vlerësimin e OJF-ve vendore në Kukës, me synim rritjen e vizibilitetit për mirë-menaxhimin ambiental dhe promovimin e tyre si mundësi e mirë bashkëpunimi në projekte të ardhshme. ACER zhvilloi një studim cilësor me OJF-ët në bashkinë Kukës. Të dhënat primare u mbështetën në vlerësimin e kapaciteteve të OJF –ve dhe në identifikimin e pengesave, impaktit, arritjet dhe mësimet e nxjerra të raportuara nga vetë pjesëmarrësit e OJF-ve në Kukës.

Në hapësirën e qeverisjes mjedisore, OJF-të janë zakonisht aktorët më të angazhuar të cilat kanë misionet e dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm, ruajtjen e pasurive natyrore dhe ujore, ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e kafshëve etj. Lloji i tyre i përfshirjes dhe operacioneve ndryshon, por mund të mbulojë nivele lokale, kombëtare, rajonale dhe / ose ndërkombëtare.

Bashkëpunimi i qëndrueshëm mes OJF-ve dhe institucioneve në Shqipëri paraqet sfida të mëdha pavarësisht progresit të arritur. Sfida të tilla mund të shihen në nivelin e mjedisit strategjik në të cilin veprojnë OJF-të; kuadri ligjor; dhe aspektet kulturore gjithëpërfshirëse që përshkojnë të gjitha format e bashkëveprimit mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike. Institucionet kanë kapacitete të kufizuara për të bërë prioritet informimin dhe konsultimin publik dhe bashkëpunimin në përgjithësi me OJF-të.

Për të forcuar rolin e OJF-ve në qeverisjen mjedisore dhe të rrisim kapacitete, projektet mund duke përdorur grantet për të ndërtuar kapacitete të brendshme në fusha të tilla si lidhshmëria, planifikimi strategjik, vetëvlerësimi, mobilizimi i burimeve dhe forcimi i aftësive teknike, administrative dhe financiare.

Hapat që duhet të ndërmerren për rritjen e vizibilitetit për mirë-menaxhimin ambiental dhe promovimin të OJF-ve:

- Bashkëpunimi i ngushtë përmes veprimit kolektiv të shoqërisë civile, është e vetmja mënyrë se si aktorët e ndryshëm të shoqërisë civile në vendimmarrjet mjedisore.
- Trajnimi i mëtejshëm do të jetë i nevojshëm për të përmirësuar kapacitetet njerëzore për pjesëmarrje sa më efektive në qeverisjen mjedisore.
- Fuqizimi i grave është thelbësor në promovimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.
- Mikro-grantet mund të promovojnë ndërgjegjësimin e komunitetit për planet lokale të menaxhimit të mbetjeve.
- Angazhimi i të rinjve është thelbësor për të nxitur mbrojtjen e mjedisit në të ardhmen.
- Media është çelësi për rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor publik.

I. Prezantimi i shkurtër i projektit

Projekti për Ujë të Pastër në Gjakovë dhe Kukës është pjesë e thirrjeve nga programet IPA për Bashkëpunim Ndër-kufitar (CBC) "Shqipëri-Kosovë 2014-2020". Dizajni i përgjithshëm i projektit synon "forcimin e marrëdhënieve të dy vendeve fqinje nëpërmjet nxitjes së zhvillimit ekonomik ndaj mjedisit dhe përfshirjes sociale të rajoneve kufitare përmes promovimit të potencialit të tyre turistik dhe respektimit të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore". Qëllimi i përgjithshëm i Programit CBC është të stimulojë zhvillimin më të balancuar, përfshirës dhe të qëndrueshëm socio-ekonomik të zonës ndër-kufitare. Zona e zgjedhur e Programit është si në vijim: në Shqipëri: Rajonet e Kukësit dhe Rajoni i Lezhës - në Kosovë: Rajoni Ekonomik Jugor, Rajoni Ekonomik Perëndimor.

Projekti zgjat 3 vite (Janar 2020 – Dhjetor 2022) dhe zbatohet nga një konsortium i organizatave jo-qeveritare SHE-ERA (partneri drejtues në Kosovë) dhe ACER (partneri lokal në Shqipëri) dhe njësitë e qeverisjes vendore Komuna Gjakovë (Kosovë) dhe Bashkia Kukës (Shqipëri).

Ky projekt synon përmirësimin e politikave dhe praktikave të mbrojtjes dhe menaxhimit të ujit përmes përmirësimit të standardeve për menaxhimin e ujërave të zeza. Aktivitetet kryesore të këtij projekti janë:

- ✓ Krijimin dhe funksionimin e Bordeve të Ujit rajonale, multi-sektoriale
- ✓ Konsultimi publik me qytetarët dhe biznesin mbi planifikimin dhe menaxhimin e ujit
- ✓ Zhvillimi i Planeve të Menaxhimit të Ujit për Kukësin dhe Gjakovën në përputhje me BE
- ✓ Monitorimi i niveleve të ndotjes së ujit në Kukës dhe Gjakovë
- ✓ Hartëzimi i zonave të ndotjes së ngurtë në lumenjtë e Kukësit dhe Gjakovës
- ✓ Ndërtimin i kolektorit të ujërave të zeza në Llukac
- ✓ Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza në Kukës dhe impiantit të trajtimit të tyre
- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës së Lumit Llukac
- ✓ Fushata Vjetore Tematike për Përmirësimin e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e burimeve ujore.
- ✓ Konkurse të OJF-ve dhe NVM-ve që promovojnë masa për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit
- ✓ Krijimi i faqeve në internet për ruajtjen e ujit në gjuhët lokale.

2. Pamje e përgjithshme e kuadrit rregullator dhe ligjor në Shqipëri

Shqipëria ka krijuar një mekanizëm koordinimi për administrimin e ujërave në të gjithë sektorët që lidhen me ujin. Për menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri është vënë në zbatim Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SIBU),¹ Kjo strategji ka për qëllim integrimin e politikave kombëtare të sektorit të ujit me ato të BE dhe paraqitjen e pikëpamjeve dhe interesave sektoriale.

Në SIBU janë përcaktuar katër shtylla:

1. **Uji për njerëzit**, që përfshin ujin e pijshëm dhe kanalizimet;
2. **Uji për ushqim**, që përfshin bujqësinë;
3. **Uji i Industrisë**, i cili përfshin hidrocentralet, burimet hidro termale, aktivitetet industriale të lehta dhe të rënda, menaxhimin e mbeturinave të ngurta, peshkimin dhe akuakulturën, transportin dhe rekreacionin;
4. **Uji për mjedisin**, që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat dhe pyjet.

Për qëllime të administrimit të ujërave, tetë basenet ujëmbledhëse të lumenjve të mëdhenj të Shqipërisë, që nga viti 1998, janë të kombinuara në gjashtë njësi kryesore hidrografike të quajtura "Basene Lumore" në përputhje me legjislacionin e BE-së [Direktiva kundër ujit e Bashkimit Evropian (DKU), Neni 3]. Agjencitë e baseneve janë baza e administrimit të burimeve të ujit. Këshillat e Baseneve kanë status ligjor dhe janë në varësi të Sekretariatit Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU). Të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Baseneve-ve përcaktohen nga KKU.

Këshilli i baseneve (KB) mbështeten nga Agjencitë e Baseneve të Lumenjve (ABL), të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Burimet Ujore, për zbatimin e vendimeve nga KB-të dhe në përgjithësi për administrimin e burimeve ujore brenda zonave të basenit të saj. Ato i mbështesin bashkitë duke zgjidhur problemet që lidhen me burimet ujore dhe janë përgjegjëse për inspektimin në vend të të gjitha aktiviteteve që lidhen me përdorimin e burimeve ujore. Megjithatë, agjencitë kanë pak autoritet për të zbatuar procedurat ligjore dhe rregullatore.²

Në tetor 2019, Këshilli i Ministrave miratoi "Strategjinë Kombëtare e Sektorit Furzimit me Ujë dhe Kanalizimeve (SFUK) për 2020-2030" (SFUK, 2019)³, e cila si objektiv kryesor përcakton menaxhimin, monitorimin dhe sigurimin e funksionimit efektiv të një sistemi të integruar për furnizimin me ujë, i cili garanton fleksibilitet në situata të ndryshme.

¹ Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 73 datë 7.2.2018 [[link](#)]

² Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 73 datë 7.2.2018 [[link](#)]

³ Strategjinë Kombëtare e Sektorit Furzimit me Ujë dhe Kanalizimeve për 2020-2030, Ministria e Infrstrukturës dhe Energjisë, [[link](#)]

SFUK-ja përcakton prioritetet e mëposhtme:

- i. zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotur;
- ii. orientimi i shërbimeve të ujit në drejtim të parimeve të kontrollit të kostos dhe rikuperimit të kostos;
- iii. përmirësimi i qeverisjes dhe rregullimit në këtë sektor;
- iv. investimi për rritjen e kapacitetit të sektorit, dhe;
- v. vajtja drejt konvergencës së plotë të ligjeve dhe rregulloreve shqiptare me Direktivat e BE-së për Ujërat.

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve parashikon mbylljen e depozitimeve të hapura me shkarkime të pakontrolluara dhe të pa trajtuara të likatit dhe zëvendësimin e tyre me 12 landfille rajonale të kontrolluara deri në vitin 2025. Duke mundësuar zbatimin e politikave kombëtare të menaxhimit të mbetjeve, rreziqet për ndotjen e ujërave nëntokësore ulen jashtëzakonisht dhe si të tilla këto politika janë të rëndësishme për zbatimin e parimeve të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore. Edhe Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin edhe Strategjia Kombëtare e Mjedisit (2015-2020), përfshijnë politikat në fushën e pylltarisë dhe ndryshimet klimatike, të cilat janë të lidhura fort me Strategjinë e Integruar të Menaxhimit të Burimeve Ujore. Ato sigurojnë një kuadër për mbrojtjen e burimeve të vlefshme natyrore të Shqipërisë. Kjo është e rëndësishme për përdorimin e qëndrueshëm të ujit nga të gjithë sektorët e tjerë⁴.

Organet kryesore përgjegjëse për administrimin e ujërave janë:

Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) organi ekzekutiv qendror për administrimin e burimeve ujore. Kryeministri kryeson KKU-në dhe mbështetet nga Sekretariati Teknik i Keshillit Kombëtar të Ujit. Organizimi i monitorimit të ujit (burimeve) në Shqipëri është i ndërlikuar, sepse mbi 20 institucione të ndryshme qeveritare janë të përfshirë, në përgjithësi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në varësinë e Ministrisë së Mjedisit, është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë dhe sasisë së burimeve ujore. Ajo mbikëqyr punën e organizmave përkatëse për monitorimin e burimeve ujore dhe është përfituesi kryesor i të dhënave të ofruara nga institucionet e mëposhtme si Instituti i GjeoShkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, fokusohet në planifikimin dhe monitorimin e hidrocentraleve, Instituti për Shëndetin Publik, dhe Autoriteti Rregullator i Ujit.

Autoriteti Rregullator i Ujit është një institucion i pavarur me detyrat e tij kryesore janë dhënia e licencave për furnizimin me ujë të pijshëm, miratimin e tarifave të ujit të pijshëm dhe aktivitetet monitoruese për furnizimin me ujë.

⁴ Menaxhimi i Burimeve Natyrore në Evropën Juglindore: Pyjet, Toka dhe Ujërat (2017), Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH [[link](#)]

2.1. Kuadri ligjor

Legjislacioni dhe rregulloret e tanishme në Shqipëri për administrimin e ujërave përfshijnë legjislacionin parësor, aktet nënligjore dhe legjislacionin ndër sektorial, duke zbatuar gjithashtu legjislacionin e BE-së. Sektori i ujërave në Shqipërisë rregullohet që nga prej vitit 1992 me Ligjin për Burimet Ujore: Nr. 8093, datë 21.3.1996.

Ligji i ri nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave" [\[link ligji\]](#) autorizon këto që vijojnë:

- Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, ujërave sipërfaqësore, të përkohshëm ose të përhershëm, ujërave të detit, ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, ujërave ndërkufitare, ujërave nëntokësore dhe gjendjen e tyre.
- Sigurimin, mbrojtjen, zhvillimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, të nevojshme për jetën dhe për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.
- Shpërndarjen e barabartë të burimeve ujore, siç parashikohet nga menaxhimi efektiv i tyre.
- Mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, përdorimi i tepruar, dhe promovimin e konsumit në varësi të nevojave aktuale.

Zbatimi dhe përafrimi i legjislacionit të BE-së

Dispozitat e Direktivës Kuadër të Ujit janë transpozuar në legjislacionin kombëtar përmes Ligjit Nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Ujit". Ky ligj është plotësisht në përputhje me Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 23 tetor 2000, "Krijimi i një kuadri ligjor për veprim të komunitetit në fushën e politikës së ujit". Transpozimi i Direktivës së Përmbytjeve (DP) ka përparuar për shkak të hartimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) mbi përmbajtjen e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit. Kjo VKM, midis direktivave të tjera të KE-së, transpozon Direktivën 2007/60/KE për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet.

2.2 Analiza SWOT për sektorin e ujit në Kukës

Bashkia e Kukësit është i pasur me burime ujore dhe diversitet të faunes dhe florës. Sistemi i ujit përfshin liqene dhe lumenjë. Rrjedhat kryesore ujore janë lumi Drini i Zi, lumi Drini i Bardhë, lumi i Lumës dhe përroi i Tërshenës. Liqeni i Fierzës, që është liqen artificial, i ndërtuar në luginën e Drinit, i cili shërben për bashkimin e rrjedhave të përrenjëve dhe lumenjeve. Lumenjtë në zonë rezikojnë nga ndotja e ujit për shkak të dekompozimit të mbeturinave bujqësore dhe industriale.

Sistemi i ujit përdoret kryesisht për energji elektrike, për aktivitete bujqësore dhe furnizim me ujë. Problemi kryesor në bashkinë e Kukësit është ndotja e ujit, kryesisht liqenit të Fierzës si rezultat i prurjeve që sjellin lumenjtë Drini i Bardhë dhe Drini i Zi, veprimtaria

ekonomike si rezultat i prurjeve që sjellin lumenjtë Drini i Badhë dhe Drini i Zi dhe shumë pak nga zonat urbane që i takonë Bashkisë Kukës.

Potenciali ujor që ka Bashkia e Kukësit, ka vlera të mëdha hidroenergjitik. Hidrocentrali i Fierzës është burimi kryesor i energjia elektrike në vend, por dhe burim kryesor i të ardhurave të qeverisë, më ndikim të drejtpërdrejtë në stabiliteti ekonomik.⁵

Tabela 1. Analiza SWOT për sektorin e ujit në Bashkinë Kukës

Anët e forta
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prania e rrjedhave ujore të shumta nëntokësore dhe sipërfaqesore. ▪ Lumenjtë që kalojnë në Bashkinë e Kukësit, përdoren për gjenerimin e energjisë elektrike dhe janë burim ujitje për bujqësinë.
Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndotja e pellgut të Fierzës si pasojë e prurjeve të sjella nga lumi Drini i Badhë dhe Drini i Zi. ▪ Mos zbatimi i marrëveshjeve dypaleshe të nëshkruara mes Bashkisë Kukës-Komunës së Prizrenit të nëshkruara për menaxhimin e mbetjeve ▪ Vështirësi dhe pengesa në lidhje me shërbimet e kanalizimeve të ujërave të zeza. ▪ Mungesa e infrastrukturës adekuate në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza. ▪ Kontrolli sanitar: Duhet të përmirësohet dhe të shtrihet në të gjithë sistemin.
Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Riorganizimi i përpunimit të ujërave. ▪ Investime për të përmirësuar shërbimin e furnizimit me ujë. ▪ Bashkëpunimi me organet rregulatore të burimeve ujore dhe OJF-të që operojnë në bashkinë e Kukësit.
Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shfrytësimi i rrjetit hidroenergjitik pa impakt për Bashkinë e Kukësit. ▪ Rreziku i përmytjeve gjatë periudhave të rreshjeve. ▪ Lidhjet e shumta informale dhe të paligjshme.

Burimi : ACER, Përshatja nga autorët :Plani i përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kukës (2017)

2.3 Roli i OJF-ve në mirëqeverisje

Shoqëria civile është një nga aktorët kryesorë në transmetimin e informacionit ndërmjet qytetarëve dhe politikës. Ajo ka një rol të rëndësishëm në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit, advokimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave, si dhe vlerësimin dhe monitorimin, duke u siguruar që shqetësimet dhe sfidat e një komuniteti të caktuar të merren parasysh nga organet vendimmarrëse. OJF-të gjithashtu promovojnë krijimin grupimeve të ndryshme të interesit për të adresuar çështjet në një mënyrë bashkëpunuese dhe për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme për trajtimin e këtyre çështjeve.

⁵ Plani i përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kukës (2017), [\[link\]](#)

Në dhjetë vitet e fundit, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë nismash për të përfshirë OJF-të në procesin e hartimit të politikave. Nga këto nisma janë krijuar disa këshilla të përbashkëta qeveri-shoqëri civile, të tilla si Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar, dhe Këshilli Kombëtar për Barazinë gjinore, mes të tjerave. Kulmi i bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri ka qenë reforma në gjyqësor. Në hartimin e paketës së reformës u angazhuan shoqatat e juristëve, qarqet akademike, dhe ekspertë të pavarur. Për më tepër, në institucionet e reja që drejtojnë gjyqësorin, si Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, bëjnë pjesë anëtarët, të cilët nuk janë gjyqtarë ose prokurorë por që kanë praktikuar avokatinë apo kërkime në botën akademike.

Shoqëria civile përfshin një gamë të gjerë aktorësh: individë, institucione kërkimore dhe akademike, si edhe organizatat jofitimprurëse / joqeveritare. Në hapësirën e qeverisjes mjedisore, OJF-të janë zakonisht aktorët më të angazhuar të cilat kanë misionet të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm, ruajtjen e pasurive natyrore dhe ujore, ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e kafshëve etj. Lloji i tyre i përfshirjes dhe operacioneve ndryshon, por mund të mbulojë nivele lokale, kombëtare, rajonale dhe/ ose ndërkombëtare.

Në veçanti, në fushën e qeverisjes mjedisore OJF-të mund të marrin një rol të rëndësishëm dhe një spektër të gjerë funksionesh. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Mobilizimi i opinionit publik: OJF-të mund të vetëdijësojnë dhe të ndikojnë në opinionin publik përmes fushatave informuese dhe shtrirjes së gjerë;
- Përfaqësimi i personave apo grupeve të papërfaqësuara: OJF-të mund të ndihmojnë në përfaqësimin e interesave civile, të cilat shpesh janë të nënpërfaqësuara në politikëbërje dhe të lehtësojnë dialogun konstruktiv midis shoqërisë civile dhe autoriteteve;
- Analizë dhe rekomandime të ekspertëve: OJF-të mund të ide dhe zgjidhje konkrete për politikëbërësit, duke lehtësuar kështu negociatat dhe duke çuar zërin dhe shqetësimet e publikut në nivelin e politikave;
- Kapaciteti i përgjigjes për të menaxhuar krizat: OJF-të shpesh demonstrojnë kapacitet dhe aftësi më të mira teknike dhe analitike për të reaguar më shpejt se zyrtarët qeveritarë dhe ofrojnë sugjerime dhe veprime konkrete në kohën e duhur.
- Menaxhimi dhe implementimi: OJF-të mund të kontribuojnë me ekspertizë teknike mbi sfidat dhe zgjidhjet mjedisore, si dhe të marrin pjesë drejtpërdrejt në aktivitete operacionale, duke mbështetur zbatimin dhe menaxhimin e projekteve dhe programeve mjedisore nga qeveritë;
- Monitorimi: OJF-të mund të ndikojnë në zbatimin e projekteve përmes monitorimit të vazhdueshëm të situatës në terren.
- Legjitimimi i mekanizmave të vendimmarrjes: OJF-të mund të zgjerojnë bazën e informacionit për vendimmarrje, duke rritur cilësinë, autoritetin dhe legjitimitetin e vendimeve dhe politikave të ndërmara, bazuar edhe në praktikën më të mira ndërkombëtare.

Bashkëpunimi i sigurtë dhe i qëndrueshëm mes OJF-ve dhe institucioneve në Shqipëri paraqet sfida të mëdha pavarësisht progresit të arritur. Sfida të tilla mund të shihen në nivelin e mjedisit strategjik në të cilin veprojnë OJF-të; kuadri ligjor; dhe aspektet kulturore gjithëpërfshirëse që përshkojnë të gjitha format e bashkëveprimit mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike. Institucionet kanë kapacitete të kufizuar për të bërë prioritet informimin dhe konsultimin publik dhe bashkëpunimin në përgjithësi me OJF-të.

2.4 Pengesat dhe Mundësitë

Ekzistenca e një shoqërie aktive civile është tregues i demokracive funksionale që i japin hapësirë në jetën publike dhe vendimmarrje larmisë së gjerë të mendimeve, shqetësimeve dhe zgjidhjeve të ndryshme. Më anë të ndërthurjes së burimeve të ndryshme publike dhe private për të arritur misionin e tyre, organizatat e shoqërisë civile janë shpesh burim novacioni shoqëror duke ofruar zgjidhje për çështje me interes publik. Mjedisi politik dhe shoqëror si dhe kuadri ligjor ndikojnë në mundësitë e OJF-ve për të vepruar dhe bashkëvepruar me institucionet publike. Si e tillë, kuadri ligjor duhet të përshtatet në mënyrë të atillë që të lehtësojë zhvillimin dhe operimin e Organizatave të Shoqërisë Civile. Për sa i përket mjedisit shoqëror, një parakusht i rëndësishëm për një shoqëri të gjallë civile është hapësira që mundësohet për diskutim publik të perspektivave të ndryshme. Në lidhje me panoramën e politikave, pjesëmarrja e zërave të ndryshëm të OJF-ve në procesin e politikave përmes bashkëpunimit të vërtetë mes shtetit dhe shoqërisë civile konsiderohet i një rëndësie të jashtëzakonshme për procesin demokratik.

Aktualisht, vihet re tendencë për të zvogëluar hapësirën e shoqërisë civile në Shqipëri, gjë që i pengon OJF-të të përcjellin zërin e komuniteteve të ndryshme dhe të kryejnë siç duhet rolin e tyre mbikëqyrës. OJF hasin pengesa në ushtrimin e plotë të funksioneve të tyre për të kanalizuar shqetësimet e qytetarëve në proceset e politikave përmes mekanizmave të duhur të pjesëmarrjes dhe konsultimit të vërtetë. OJF-të shqiptare shpesh perceptohen si të ndikuara nga axhenda politike dhe interesa të veçanta të fuqishme.

Edhe pse angazhimi i shoqërisë civile është me rëndësi kritike, pjesa më e madhe e organizatave vuajnë nga kapacitetet e pamjaftueshme, kanë mangësi në burime dhe në të kuptuar të problematikave për të pasur një ndikim të rëndësishëm. Prandaj, ndonëse OJF-të në nivelin vendor kanë lidhje më të forta me komunitetin, ato kanë kufizime të konsiderueshme për sa i përket strukturave, burimeve dhe kompetencave të duhura për të ndërvepruar në mënyrë të qëndrueshme dhe kuptimplote me vendimmarrësit.

Mungesa e vullnetit politik për të realizuar procese të vërteta konsultimi dhe për të përmirësuar bashkëpunimin mes OJF-ve dhe institucioneve është evidente. Institucionet shtetërore nuk e konsiderojnë angazhimin me OJF-të si të rëndësishëm për promovimin e interesit publik, por më tepër si një barrë tjetër pune pa ndonjë ndikim të madh. Rrjedhimisht,

kjo gjë rrit edhe më shumë mosbesimin e ndërsjellë mes institucioneve publike dhe OJFve në lidhje me bashkëpunimin dhe ndikimin e tij. Pjesa më e madhe e ndërveprimit mes dy subjekteve pengohet nga kultura e kufizuar transformuese në institucionet shtetërore.

Përtej të gjitha pengesave, shoqëria civile ka të gjitha mundësitë të jetë një aktor i rëndësishëm në vendimmarrje dhe të ndikojë në përcimin e zërit të grupeve të ndryshme të interes në institucione. Me zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve dhe hapësirën për të vepruar, OJF -të përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për administratën rajonale/lokale duke ofruar ekspertizë dhe informacion koherent rreth zhvillimeve mjedisore. OJF-të mund të ndërhyjnë për të ndihmuar në ofrimin e shërbimeve dhe për të mbështetur politikat e qeverisë dhe funksionet e menaxhimit. OJF zhvillojnë një veprim kontrolli dhe monitorimi të respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare/ ndërkufitare duke nxitur shtetet/ njësitë administrative ti japin përparësi zbatimit të marrëveshjeve. Këto përfshijnë ndërmarrjen e veprimeve të pavarura, si dhe punën në bashkëpunim me agjencitë qeveritare në nivele të ndryshme mbi formimin dhe zbatimin e politikave, kryerjen e kërkimeve, monitorimin e cilësisë së mjedisit, pjesëmarrjen në edukimin mjedisor, ngritjen e vetëdijes për problemet e ngutshme mjedisore dhe kërkimin e zgjidhjeve dhe menaxhimin e drejtpërdrejtë të burimeve natyrore - siç janë zonat e mbrojtura - së bashku me komunitetet dhe grupet e qytetarëve. Në mungesë të kanaleve të tjera, OJF-të mjedisore mund të përfaqësojnë popullata të prekshme dhe të marginalizuara dhe të shërbejnë si një kanal për pikëpamjet e pakicave në debatin e politikave, duke kontribuar kështu në një shoqëri civile aktive.

3. Metodologji e Studimit

Metodologjia e zbatuar në këtë studim bazohet në qëllimin dhe fokusin e projektit “Për ujë të pastër në Gjakovë dhe në Kukës” për Bashkëpunim Ndërkufitar (CBC) “Shqipëri – Kosovë 2014-2020”, i cili është forcimi i marrëdhënieve të dy vendeve fqinje nëpërmjet nxitjes së zhvillimit ekonomik ndaj mjedisit dhe përfshirjes sociale të rajoneve kufitare përmes promovimit të potencialit të tyre turistik dhe respektimit të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.” Synimi i projektit për përmirësimin e politikave dhe praktikave të mbrojtjes dhe menaxhimit të ujit dhe përfshirja e OJF-ve vendore në promovim dhe mbrojtjen e burimeve ujore është pasqyruar në zhvillimin metodologjik të këtij studimi.

3.1 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim ka si qëllim vlerësimin e OJF-ve vendore në Kukës, me synim rritjen e vizibilitetit për mirë-menaxhimin ambiantal dhe promovimin e tyre si mundësi e mirë bashkëpunimi në projekte të ardhshme.

Ojektivat kryesore të këtij studimi janë:

1. Vlerësimi i projekteve/ studimeve të zhvilluara nga OJF-ët në Kukës, me tematikë kryesore mjedisin: menaxhimin, sensibilizimin, promovimin, rritjen e kapaciteteve apo përmirësimin e politikave dhe praktikave të mbrojtjes së mjedisit etj.
2. Vlerësimi i kapaciteteve të OJF-ve në Kukës:
 - a. Kapaciteti për përfshirje në analiza të politikave dhe proceseve të dialogut kombëtar në lidhje me qeverisjen dhe menaxhimin e mjedisit.
 - b. Kapacitetet për të gjeneruar, aksesuar dhe përdorur informacion dhe rritje njohurish.
 - c. Kapacitetet për zhvillimin e strategjisë politikave dhe legjislacionin në menaxhimin e mjedisit.
 - d. Kapacitetet për menaxhim dhe implementim (zhvillimin e projekteve, mobilizimin e burimeve, planifikimin e burimeve).
 - e. Kapacitetet për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimet dhe trendet mjedisore.
3. Identifikimi i pengesave, impakti dhe mësimet e nxjerra të OJF-ve në Kukës, në kuadër të projekteve/ studimeve të ndërmarra në lidhje me mjedisin.

3.2 Dizajni i Studimit

Qasja metodologjike e zbatuar nga ACER është bazuar në të dhëna primare dhe të dhëna sekondare për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e këtij studimi.

Të dhëna primare: ACER zhvilloi një studim cilësor me OJF-ët në bashkin Kukës. Të dhënat primare u mbështetën në vlerësimin e kapaciteteve të OJF –ve dhe në identifikimin e pengesave, impaktit, arritjet dhe mësimet e nxjerra të raportuara nga vetë pjesëmarrësit e OJF-ve në Kukës. Qëllimi i studimit cilësor, me anë të dhënave primare, është që të kemi një informacion të vlefshëm dhe të besueshëm, i cili nuk mund të merret me anë të të dhënave të tjera sekondare, duke zhvilluar kështu gjetjet kryesore dhe konkluzionet e këtij studimi.

Të dhëna sekondare: Të dhënat sekondare përfshin mbledhjen e të dhënave që ekzistojnë tashmë ose nga burimet e brendshme të agjencive të përfshira në projekt (dokumentat e projektit/ objektivat e zhvillimit/ treguesit/ raportet paraprake, narrative, etj.), botimet e institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare, të dhënat e hyrjes së lirë në internet, në mënyrë profesionale gazeta dhe revista, raporte të organizatave ndërkombëtare, etj. Shqyrtimi i literaturës dhe grumbullimi sekondar i të dhënave është thelbësor që në fazën fillestare për të fituar formim dhe njohuri specifike për këtë temë, si dhe sigurimin e udhëzuesve të dobishëm që do të ndihmojnë për të marrë maksimumin nga studimi.

3.2.1 Kampionimi i studimit dhe mbledhja e të dhënave

Në fillim të zhvillimit të projektit “Për ujë të pastër në Gjakovë dhe në Kukës”, ACER ka identifikuar OJF-ët në bashkinë e Kukësit, në një listë prej 22 OJF (shih shtojcën 2). 20 OJF janë kontaktuar fillimisht nga ACER, për të listuar projektet/ studimet e tyre me tematikë kryesore mjedisin: menaxhimin, sensibilizimin, promovimin, rritjen e kapaciteteve apo përmirësimin e politikave dhe praktikave të mbrojtjes së mjedisit etj. Pas një vlerësimi të projekteve dhe studimeve të 20 OJF-ve në bashkinë e Kukësit, 7 prej tyre u përzgjedhën për një vlerësim të dytë të kapaciteteve, pengesave, arritjeve, impaktit dhe mësimet e nxjerra në kuadër të projekteve të ndërmarra (shih [shtojcën 3](#)). OJF-ët u kontaktuan me anë të e-mailit dhe telefonit nga eksperti në ACER në bashkinë e Kukësit. Mbledhja e të dhënave u zhvillua gjatë një periudhe dy javore (10 Maj – 21 Maj, 2021). Kampioni përfundimtar i studimi është 6 OJF në Kukës, siç janë listuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Numri i kampionit të përfshirë në studim

Nr.	Kampioni (OJF e përfshira në studim)	Kontakti
1.	DMO Kukës	dmokukes@gmail.com

2.	Ekologët për Rajonin Kukës	ekologetrajonit@gmail.com
3.	Federata e Përdoruesve të pyetjeve, Kukës	fedkuk@yahoo.com
4.	Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit	mbrojtjamjedisit@yahoo.com
5.	Qendra për Progres Rinor	orgcyp@hotmail.com
6.	Shoqata mjedisore SIRA	shoqata_sira_kukes@yahoo.com
7.	Shoqata e Pyetjeve dhe Kullotave	shpk_novosej@hotmail.com

Burimi: ACER “Vlerësimi i OJF-ve në Bashkinë e Kukësit, me qëllim rritjen e Vizibilitetit dhe Mirë-menaxhimin Mjedisor”, 2021

3.2.2 Analiza e të dhënave

Cdo intervistë e zhvilluar nga OJF-ët në bashkinë e Kukësit, u ruajt në serverin e gjendur në zyrat e ACER. Për pyetjet e paqarta dhe jo të mirë analizuara, u ri kontaktuan përsëri OJF-ët përkatëse, me qëllim që vlerësuesit e këtij studimi të kishin një pamje më të gjerë të pyetjeve dhe të rezultateve të këtij studimi. Intervistat u panë dhe ripanë nga 3 vlerësues dhe më tej u bë analiza e të dhënave në funksion të qëllimit dhe objektivave të studimit.

3.3 Limitet e studimit

Vlen të theksohet se, për shkak të periudhës pandemike (Covid-19), intervistat e thelluar me OJF-ët në bashkinë e Kukësit janë zhvilluar me anë të takimeve online dhe jo ballë për ballë. Gjithashtu, në këtë studim janë përfshirë një numër i vogël i OJF-ve në bashkinë e Kukësit, duke qenë se vetëm këto OJF ishin të përfshira në projekte dhe studime me tematikë kryesore mjedisin.

4. Gjetjet e Studimit

4.1 Vlerësimi i kapaciteteve të OJF

Vlerësimi i bërë nga ACER u mbështet nga 5 pohime të lidhura me kapacitetet e OJF-ve në bashkinë e Kukësit. Duke u bazuar në opinionet e drejtuesve të OJF-ve, më poshtë paraqitet një përmbledhje e shkurtër për çdo pohim dhe tabela përmbledhëse e rezultateve.

1. Kapaciteti për përfshirje në analiza të politikave dhe proceseve të dialogut kombëtar ose nën-kombëtar⁶, në lidhje me qeverisjen dhe menaxhimin e mjedisit.

Rritja e kapaciteteve për përfshirjen e palëve të interesuara në hartimin e politikave arrihet duke krijuar tryezave të rrumbullakëta me aktorë të fushës në mënyrë që OJF-te bashkëpunojnë me institucionet qeveritare për përcaktimin e axhendës së konsultimeve dhe proceseve të zhvillimit të politikave për menaxhimin e mjedisit.

2. Kapacitetet për të gjeneruar, aksesuar dhe përdorur informacion dhe rritje njohurish

Përmirësimi dhe forcimi i rolit të OJF-ve në lidhje me ndërgjegjësimin për çështjet dhe politikat mjedisore. Aksesueshmëria në informacion dhe rritja e njohurive mjedisore në mënyrë që OJF-të të adresojnë problemet dhe të gjendet zgjidhja e përshtatshme.

3. Kapacitetet për zhvillimin e strategjisë, politikave dhe legjislacionit në menaxhimin e mjedisit

Forcimi i kapacitetit të organizatave për të marrë pjesë në zhvillimin e politikave dhe kuadrit legjislativ për qeverisjen dhe menaxhimin e mjedisit. Kjo përfshin ngritjen e shqetësimeve mjedisore në nivel institucional dhe në nivelin kombëtar. Promovimin e dialogut konstruktiv midis qeverisë dhe drejtuesve të OJF-ve për formulimin e politikave mjedisore.

4. Kapacitetet për menaxhim dhe implementim (zhvillimin e projekteve, mobilizimin e burimeve, planifikimin e burimeve)

Përmirësimi i kapacitetit organizativ, përfshirë aftësitë në zhvillimin e projekteve, mobilizimin e burimeve, planet e biznesit dhe kapacitetin administrativ, për të marrë pjesë në zbatimin e aktiviteteve, si dhe në hartimin e politikave dhe reformat mjedisore.

⁶ Këtu mund të përdoret termi rajonal dhe lokal


5.Kapacitetet për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimet dhe trendet mjedisore

Përmirësimi i kapacitetit organizativ për të monitoruar dhe vlerësuar problemet mjedisore, informim për planifikimin e politikave dhe proceseve të vendimmarrjes, dhe mbështetje për ndryshimet e politikave, duke rritur kështu përgjegjësitë e OJF-ve.

4.2 Vlerësimi i kapaciteteve të OJF-ve në bashkinë Kukës

ACER vlerësoi kapaciteteve e OJF-ve në bashkinë e Kukësit nëpërmjet përdorimit të shkallës Likert nga 1-Shumë pak tek 5-Shumë. Në grafikun e mëposhtëm praqiten vleresime e bëra nga ACER për OJF-të pjesëmarrëse në studim. Kapaciteti për përfshirje në analiza të politikave dhe proceseve të dialogut kombëtar për çështjet mjedisore është vlerësuar “mesatarisht” nga OJF-të. OJF-të e përfshira në studim vlerësuan “deri diku”, kapacitetet që lidhen me zhvillimin e projekteve, mobilizimin e burimeve, planifikimin e burimeve. Po ashtu edhe kapacitetet për të monitoruar dhe vlerësuar problemet mjedisore. Ndërkohë kapacitetet e OJF-ve për zhvillimin e strategjive, politikave dhe legjislacionit në lidhje me menaxhimin e mjedisit janë të pakta (Vlerësimi për këtë kapacitete është i barazvlefshëm me dy, që do të thotë “pak”).

Grafikë I. Vlerësimi i kapaciteteve



Burimi: ACER “Vlerësimi i OJF-ve në Bashkinë e Kukësit, me qëllim rritjen e Vizibilitetit dhe Mirë-menaxhimin Mjedisor”, 2021

4.3 Ndërtimi i kapaciteteve të brendshme dhe të jashtme të OJF-ve

Për të forcuar rolin e OJF-ve në qeverisjen mjedisore dhe të rrisim kapacitete, projektet mund të përfshijnë aktivitete të ndryshme të hartuara posaçërisht për të kontribuar në një rezultat të veçantë. Grantet përdoren nga OJF-të për të ndërtuar kapacitete të brendshme në fusha të tilla si lidhshmëri, planifikimi strategjik, vetëvlerësimi, mobilizimi i burimeve dhe forcimi i aftësive teknike, administrative dhe financiare. Në mënyrë që të ndërtohen kapacitete të jashtme, grantet mbështesin trajnimin në fushat që përmirësojnë

avokimin, aftësitë teknike dhe shkencore, dhe aleancat në mënyrë që të marrin pjesë në hartimin e politikave, dialogje të ndryshme dhe aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit.

Për sa i përket kapaciteteve të jashtme, grantet mbështesin trajnime konceptuale dhe praktike në disa fusha të rëndësishme që lidhen me qeverisjen mjedisore:

- Pjesëmarrja në vendimmarrjen mjedisore;
- Trajnime për legjislacionin mjedisore përmes qasjeve në ligj, gjykata dhe opinionin publik;
- Përdorimi i fushatave të komunikimit dhe mediave strategjike për të promovuar qeverisjen mjedisore;
- Ndërtimi i aleancave dhe rrjetit të OJF-ve në shkallë vendi dhe rajonal;
- Mbledhja, analizimi dhe promovimi i aksesit në informacionin mjedisor dhe të zhvillimit të qëndrueshëm;
- Vlerësimi dhe monitorimi i politikave, pjesëmarrja në konsultimet e politikave dhe zbatimin e tyre;
- Vlerësimi i kushteve mjedisore dhe monitorimi i pajtueshmërisë me ligjet dhe marrëveshjet mjedisore (nga ana e qeverisë, industrisë, komuniteteve, etj.).

Tabela 3. Shembuj aktivitetesh për të rritur kapacitetet

Rezultati i Kapacitetit	Shembuj aktivitetesh për të rritur kapacitetit
Rezultati 1: Kapaciteti për përfshirje në analiza të politikave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i partneritetit strategjik midis OJF-VE me qëllim zhvillimin e tryezave të rrumbullakëta me aktorë të politikës dhe jo vetëm me fokus përcaktimin e axhendës dhe proceseve të hartimit të politikave mjedisore.
Rezultati 2: Kapacitetet për të gjeneruar, qasur dhe përdorur informacion dhe njohuritë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpërndarja e informacionit mbi pasojat mjedisore të aktiviteteve ekonomike me qëllim promovimin e ndryshimeve të sjelljes. ▪ Ndërgjegjësimi mbi sfidat mjedisore, politikat dhe masat, si dhe avokimi për të ndryshuar.
Rezultati 3: Kapacitetet për zhvillimin e strategjisë, politikave dhe legjislacionit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikimi i sfidave dhe problemeve mjedisore, promovimi i një dialogu konstruktiv midis qeverisë dhe drejtuesve të OJF-ve me qëllim hartimin e masave lehtësuese. ▪ Vlerësimi dhe rishikimi i politikave ekzistuese mjedisore në nivel kombëtar dhe zhvillimi i rekomandimeve për të promovuar praktika të qëndrueshme.
Rezultati 4: Kapacitetet për menaxhim dhe implementim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përfshirja e OJF-ve në procesin e hartimit, zbatim të politikave në nivelin kombëtar për çështjet mjedisore
Rezultati 5: Kapacitetet për të monitoruar dhe vlerësuar	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përgjegjësia e sektorit publik për të krijuar hapësira për përfshirjen e OJF-ve për të monitoruar problemet dhe vazhdueshmëriën, me qëllim ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e ndryshimit. ▪ Njohuri organizative, financiare dhe teknike, dhe kapacitete të planifikimit strategjik brenda vetë OJF-së.

Burimi: Përshtatje nga autorët

4.2 Impakti dhe arritjet e OJF

Siç përshkruhet më sipër, organizatave jo fitimprurëse shpesh u mungojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme ligjore për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset e qeverisjes mjedisore. Për më tepër, institucionet qeveritare, megjithëse janë të mandatuara për të përfshirë publikun e gjerë në vendimmarrje, rrallë shndërrojnë rekomandimet e shoqërisë civile në politika në një mënyrë adekuate. Si rrjedhojë, grantet e donatorëve të mëdhenjë, duhet të mbështesin iniciativat në bashkinë e Kukësit dhe jo vetëm, të përqëndruara fuqimisht në fuqizimin e organizatave jo-fitimprurëse për të marrë pjesë në proceset e qeverisjes mjedisore. Këtu përfshihen përpjekje për të ndërtuar kapacitete institucionale të OJF-ve për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështjet mjedisore dhe për të forcuar aftësinë e tyre për të analizuar dhe ndikuar në kornizën aktuale ligjore në Shqipëri.

Pjesëmarrja e organizatave jo-fitimprurëse në proceset e qeverisjes mjedisore. Organizatat jo fitim prurëse të përfshira në studim kanë raportuar se janë përfshirë në diskutime/ tavolina të përbashkëta midis OJF dhe organeve qeveritare lokale me qëllim identifikimin e problematikave dhe dhënien e ideve/ rekomandimeve mbi procese të ndryshme mjedisore. Pavarësisht, takimeve të zhvilluara, kërkohet një pjesëmarrje më e gjerë dhe më efektive në qeverisjen mjedisore. Gjithashtu, nga OJF në bashkinë e Kukësit shprehet një nevojë për pjesëmarrje më e fortë në politikëbërje dhe partneritete të forcuara në institucionet vendore dhe kombëtare.

Përmirësimi i politikave dhe praktikave të mbrojtjes së mjedisit. Projekte dhe studime me fokus përmirësimin e politikave të mbrojtjes së mjedisit janë zhvilluar nga OJF-ët në bashkinë e Kukësit. Një nga projektet e zhvilluara nga Federata e Përdoruesve të Pyjeve në bashkinë e Kukësit është “Decentralizimi i Pushtetit vendor; Inventarizimi dhe transferimi i pronave publike tek pushteti vendor” me qëllim evidencimin e VKM për transferimin e pronave të patundshme nga pushteti qendror tek pushteti vendor. Vlerësimi i qeverisjes nga institucionet përgjegjëse për mjedin me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e politikave ka qenë një nga projektet e zhvilluara nga Ekologët për Rajonin Kukës me titull “KU-KË-SI Qeveriset”.

Forcimi i kapaciteteve për advokim dhe lobim. Si një nga arritjet me impakt të rëndësishëm nga OJF-ët e përfshira në studim, është rritja e aktiviteteve lobuese dhe advokuese. “Fuqizimi i kuadrit institucional, ligjor dhe politikave lidhur me pyjet komunal me vëmendje të veçantë në parimet e qeverisjes së mirë” është një nga projektet e zhvilluara nga Federata e Përdoruesve të Pyjeve me qëllim rritjen e aktiviteteve advokuese/ lobuese dhe përmirësimin e kuadrit ligjor “ Ligji i pyjeve dhe politikat pyjore”. Vlen të theksohet se ka vend për përmirësim në forcimin e kapaciteteve të OJF-ve mbi aktivitetet advokuese dhe lobuese.

Ngritja e kapaciteteve dhe ndarja e njohurive. OJF-ët në bashkinë e Kukësit kanë në fokus kryesor ndërtimin e vazhdueshëm të kapaciteteve lokale dhe ndarjen e

njohurive me institucione publike ose jo-publike në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Impakt më i gjerë i projekteve dhe studimeve të zhvilluara është përcjellja e njohurive të publiku (kryesisht tek të rinjtë) mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe pasojat e mundshme në shëndetin e njeriut nga një mjedis i ndotur.

Ndërgjegjësim, Sensibilizim dhe Promovim. Projektet dhe studimet në fushën e ndërgjegjësimit, sensibilizimit dhe promovimit të çështjeve mjedisore në bashkinë e Kukësit janë zhvilluar nga të gjitha OJF-ët të përfshira në këtë studim. “Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në ZM” dhe “Rritja e kapaciteteve lokale për mbrojtjen dhe promovimin e natyrës në zonën e Hasit” janë dy nga projektet kryesore të organizatës Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit me ndikim promovues. Sensibilizimi, rritja e kapaciteteve dhe promovimi janë objektivat kryesore të projekteve të zhvilluara nga Ekologët për Rajonin Kukës, si psh: ‘Klub dhe Kopësht i Gjelbër’; “Rrjeti Ekologjike”; Agro Turizmi në Qarkun Kukës” etj.

Rritja e aksesit në informacion mjedisor nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe trajnimit. Identifikimi dhe nxitja e bizneseve të gjelbërat nëpërmjet rritjes së njohurive është një nga fokuset e projektit “Bizneset e Gjelbërta” të zhvilluar nga Ekologët për Rajonin Kukës. Impakt të gjerë kanë pasur trajnimet për ndërgjegjësim më të madh mjedisor publik dhe përfshirja më e gjerë e të rinjve dhe grave në informacionin mjedisor. Trajnimet me aktorët lokal (strukturat e bashkive) ka qenë një nga fokuset e projektit “Fuqizimi i kuadrit institucional, ligjore dhe politikave lidhur me pyjet komunal me vemendje të vecante në parimet e qeverisjes së mirë” të zhvilluar nga Federata e Përdoruesve të Pyejeve. Si rrjedhojë, mund të theksohet se OJF në bashkinë e Kukësit kanë pasur impakt në rritjen e aksesit në informacionin mjedisor nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe trajnimit.

4.3 Mësimet e nxjerra

Bashkëpunimi i ngushtë përmes veprimit kolektiv të shoqërisë civile, është e vetmja mënyrë se si aktorët e ndryshëm të shoqërisë civile në vendimmarrjet mjedisore. Për të ndikuar në ndryshimet në nivel kombëtar, është e rëndësishme që përfaqësuesit e shoqërisë civile të komunikojnë rekomandime të qëndrueshme dhe të unifikuara. Për më tepër, koalicionet e OJF-ve që demonstrojnë një grup gjithëpërfshirës të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve dhe përfaqësojnë rajone të ndryshme ka më shumë të ngjarë të kenë një zë më të fuqishëm në negociata dhe të marrin pjesë në mënyrë efektive në zhvillimin e politikave mjedisore. Takimet sistematike, specifike të çështjeve midis OJF-ve dhe aktorëve të tjerë të interesuar, dhe trajnimi për zhvillimin organizativ për të përmbushur nevojat institucionale të OJF-ve individuale, janë thelbësore për të ndërtuar aftësitë e nevojshme dhe mirëkuptimin e përbashkët midis këtyre organizatave.

Kjo qasje gjithashtu nxit rrjetëzimin dhe partneritetin midis palëve të interesuara, lehtëson shkëmbimin e njohurive dhe përvojave dhe shpesh ofron një mundësi për të aplikuar aftësi të reja në praktikë përmes projekteve dhe iniciativave të përbashkëta. Rrjetet e

organizatave të palëve të interesit që punojnë drejt një qëllimi të përbashkët janë mjete efikase për të shkëmbyer njohuri dhe për të promovuar ndryshimet. Në këto rrjete duhet që secila organizatë anëtare të ketë mundësi të barabarta për të paraqitur dhe shprehur mesazhet dhe rekomandimet e tyre kryesore, për të ndarë praktikrat e tyre dhe për të mësuar nga të tjerët.

Përdorimi aktiv i rrjeteve sociale dhe platformave të komunikimit është thelbësor për të rritur ndërgjegjësimin tek popullata kryesisht e re. Duke marrë parasysh që shumica e popullsisë në vend është në moshë të re dhe përdorimi i gjerë i rrjeteve sociale do të ishte një mënyrë efektive për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të përfshirjes së të rinjve në komunitetin në çështjet mjedisore. Platforma të tilla si Facebook, Tëitter dhe YouTube do të ishin tejet efektive për këtë qëllim. Bashkëpunimi i vazhdueshëm midis OJF-ve mjedisore dhe vendimmarrësve do të jetë thelbësor për të rritur eficienten e projekteve. Dialogu dhe bashkëpunimi do të sigurojë që rezultatet e projektit të jenë të qëndrueshme dhe do të sigurojnë një platformë për partneritete të suksesshme në të ardhmen. Organizata lokale që vepron në Bashkinë Kukës “Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi I Turizmit” shprehet se *“pengesa kryesore me të cilën ne si OJF përballemi në zhvillimin e projekteve është mungesa e bashkëpunimit me qeverisjen vendore”*.

Një bazë e qëndrueshme legislative për pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe kornizat e mundshme për angazhimin aktiv civil në qeverisjen mjedisore. Vetëm iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve nuk janë të mjaftueshme për pjesëmarrjen aktive të OJF-ve në menaxhimin e mjedisit, por duhet të shoqërohen me një bazë të qëndrueshme legislative. Për shembull krijimi i një laboratorit të centralizuar të vlerësimit dhe monitorimit mjedisor për OJF-të kombëtare mund të kontribuojë në rritjen e mëtejshme të kapaciteteve institucionale të organizatave të shoqërisë civile në qeverisjen mjedisore, vlerësimet e rrezikut, zbatimin e projektit dhe monitorimin, ndër të tjera.

Trajnimi i mëtejshëm do të jetë i nevojshëm për të përmirësuar kapacitetet njerëzore për pjesëmarrje sa më efektive në qeverisjen mjedisore. Gjatë projekteve të mbështetura nga organizata të Bashkimit Europian, janë evidentuar mangësi në kapacitetet lokale për t'u angazhuar dhe për të bashkëpunuar me autoritetet. Federata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave, që operon në Qarkun Kukës shprehet se *“...mungesa e kapaciteteve njerëzore për të aplikuar dhe menaxhuar projekte mjedisore nga OJF lokale dhe mungesa e bashkëpunimit nga OJF-të e konsoliduara me eksperiencë dhe kapacitete më të mëdha që operojnë në nivel kombëtar është një nga pengesat kryesore që ne si OJF hasim.”* Adresimi i këtij problemi do të kërkojë trajnim të mëtejshëm në të ardhmen. OJF-të mjedisore duhet që vazhdimisht të marrin trajnime të mëtejshme tematike mbi çështjet mjedisore dhe zgjidhjet e mundshme. Do të ishte gjithashtu e dobishme që të krijohen mekanizma që këto OJF të përqendrohen në të ardhmen në mbikëqyrjen e vazhdueshme të mjedisit për të rritur efektivitetin e qeverisjes mjedisore.

Partneritetet e shumë palëve dhe platformat e dialogut janë kryesore për përmirësimin e qeverisjes mjedisore në planin afatgjatë. Netëorku dhe dialogu janë mjete të fuqishme për të shkëmbyer njohuri dhe për të ndërtuar strategji, si dhe për të forcuar potencialin e OJF-ve

mjedisore për të ndikuar në hartimin e politikave në nivelet kombëtare, rajonale dhe lokale. Në të njëjtën kohë, partneritetet dhe platformat afatgjata me shumë aktorë (që përfshijnë, për shembull, autoritetet qeveritare, OJF-të, aktorët e sektorit privat dhe institucionet e arsimit dhe kërkimit) janë të nevojshme për të sjellë në tryezë mendime, ekspertizë dhe përvoja të ndryshme nga sektorë të ndryshëm. Këto janë gjithashtu thelbësore për të krijuar një lloj konsensusi midis palëve të interesuara të nevojshme për të shmangur kundërshtimin në të ardhmen. Fuqizimi i grave po ashtu është thelbësor në promovimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.. Sidoqoftë, përfaqësimi i grave në pozitat e vendimmarrjes është ende i ulët dhe ato shpesh nuk janë në gjendje të shprehin shqetësimet e tyre specifike. Komitetet e përcaktuara, me anëtarët që përmbushin funksione të ndryshme të tilla si planifikimi dhe koordinimi strategjik, komunikimi, rrjetëzimi, monitorimi dhe vlerësimi, mund të ndihmojnë për të lehtësuar angazhimin dhe bashkëpunimin afatgjatë.

Mikro-grantet mund të promovojnë ndërgjegjësimin e komunitetit për planet lokale të menaxhimit të mbetjeve. Një komponent mikrogranti që siguron qasje në financat lokale mund të jetë një plotësues i mirë i planeve të veprimit të menaxhimit të mbeturinave të komunitetit. Mund të sigurojë një mekanizëm të fortë për mobilizimin e komuniteteve, ndërtimin e kulturës së bashkë-financimit të komunitetit, si dhe rritjen e kapaciteteve të implementimit të menaxhimit të mbeturinave të komuniteteve të synuara përmes aftësisë për të provuar qasjet inovative të menaxhimit të mbetjeve në terren.

Angazhimi i të rinjve është thelbësor për të nxitur mbrojtjen e mjedisit në të ardhmen. Integrimi i çështjeve mjedisore në programet shkollore ka një efekt thelbësor pozitiv në ndërgjegjësimin e komunitetit. Rinia është lajmëtar, mbrojtës dhe agjent i ndryshimit. Ata mund të avokojnë për mbrojtjen e mjedisit dhe mund të tregojnë nëpërmjet shembullit të tyre. Përmes eko-klubeve, për shembull, fëmijët mësojnë rreth çështjeve mjedisore lokale dhe marrin pjesë aktivisht në adresimin e tyre, fitojnë aftësi kërkimore, bëhen aktorë të mbrojtjes së mjedisit dhe promovojnë sjellje miqësore me mjedisin. Në fund, ata bëhen qytetarë të shqetësuar të cilët mund të marrin vendime të informuara dhe të ndikojnë pozitivisht në vendimet e të tjerëve. Eko-klubet, përmes promovimit në mediat sociale si dhe kryerja e fushatave ndërgjegjësuese, janë mjete efektive për angazhimin e të rinjve, përhapjen në terren, avokimin dhe ndryshimin e sjelljes, dhe kështu përfaqësojnë mekanizma të fortë për të ndikuar në vendimmarrje.

Media është çelësi për rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor publik. Qeverisja e mirë mjedisore mund të arrihet vetëm kur të gjithë, nga të rinjtë te të moshuarit, e kuptojnë rëndësinë e mjedisit si dhe nevojën për ta mbrojtur dhe ruajtur atë. Për këtë qëllim, roli i mediave në përhapjen dhe edukimin e informacionit është kritik. Prandaj trajnimi i një brezi gazetarësh për të kuptuar rëndësinë e burimeve natyrore dhe vlerën e institucioneve përgjegjëse, dhe për të pasqyruar këtë kuptim në raportimin e zgjuar të çështjeve mjedisore, është thelbësore për prodhimin e një shoqërie të informuar dhe të edukuar për mjedisin, e cila mund të marrë pjesë aktive në vendimmarrje dhe politikëbërje.

Partneritetet janë jetike për suksesin e qeverisjes me fokus politikat mjedisore. Gatishmëria e autoriteteve shtetërore për të bashkëpunuar me shoqërinë civile është e domosdoshme për proceset pjesëmarrëse të qeverisjes mjedisore. Po ashtu vendndodhja gjeografike e vendeve të projektit duhet të përcaktohet me kujdes. Duhet të zhvillohet një plan gjithëpërfshirës i zbatimit kur zgjedh vendet e projektit në mënyrë që partnerët e përshtatshëm lokal të mbështesin aktivitetet e projektit. Përfshirja drejtuesit e komunitetit në shpërndarjen e informacionit dhe angazhimi i tyre në aktivitetet mjedisore është tejet i rëndësishëm. Partneriteti me drejtues të besueshëm të komunitetit, të tillë si mësues, profesorë, përfaqësues fetarë dhe figura politike, dhe ndërtimi i kapaciteteve të tyre për të marrë pjesë në ndërgjegjësimin mjedisor dhe iniciativa të ndryshme, mund të rrisë ndjeshëm besimin dhe bashkëpunimin nga komunitetet dhe organizatat lokale. Këta partnerë mund të funksionojnë në mënyrë efektive si shumëzues të informacionit.

Ndërgjegjësimi kombëtar mjedisor është veçanërisht i ulët në komunitete të vogla rurale, me kontribut të kufizuar të OJF-ve dhe sektorit privat në këtë fushë, dhe burime të kufizuara të informacionit. Mbështetja e dobët mjedisore si e qeverisë lokale shpesh dekurajon aktorët e shoqërisë civile të flasin dhe të marrin pjesë në një diskutim të shqetësimeve mjedisore. Ka një mungesë të konsiderueshme të kapitalit njerëzor në fushat mjedisore në Shqipëri. Sidoqoftë, studentët dhe të rinjtë janë duke treguar një interes më të madh për çështje mjedisore dhe zgjidhje të qëndrueshme për sfidat e sotme mjedisore. Këta të rinj mund të promovojnë një ndryshim në perceptimet e shoqërisë në lidhje me shqetësimet mjedisore si dhe ndryshimet në praktikave ekzistuese që nuk i marrin në konsideratë ndikimet mjedisore në hartimin e politikave. Projektet e OJF-ve të BE-së që mbështesin edukimin mjedisor janë një investim efektiv në zhvillimin e individëve që mund ti prijnë ndryshimit.

5. Konkluzionet dhe Rekomandimet

5.1 Konkluzionet kryesore

Disa nga konkluzionet kryesore të nxjerra nga shqyrtimi i literaturës dhe nga studimi: “Vlerësimi i Organizatave Jo- Fitimprurëse në Bashkinë e Kukësit, me qëllim rritjen e Vizibilitetit dhe Mirë-menaxhimit Mjedisor” janë:

- Shqipëria ka krijuar një **mekanizëm koordinimi për administrimin e ujërave** në të gjithë sektorët që lidhen me ujin. Për menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri është vënë në zbatim Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SIBU).
- Bashkia e Kukësit është **i pasur me burime ujore** dhe diversitet të faunes dhe florës. Burimet kryesore ujore janë liqeni dhe lumenjtë. Rrjedhat kryesore ujore janë lumi Drini i Zi, lumi Drini i Bardhë, lumi i Lumës dhe përroi i Tërshenës.
- Burimet ujore përdoren kryesisht për energji elektrike, për aktivitete bujqësore dhe furnizim me ujë të qendrave të banuara. **Problemi kryesor në Bashkinë e Kukësit është ndotja e ujit**, në mënyrë të veçantë nga prurjet që sjellin lumenjtë Drini i Bardhë dhe Drini i Zi.
- Shoqëria civile është një nga aktorët kryesorë në transmetimin e informacionit ndërmjet qytetarëve dhe politikës. Në dhjetë vitet e fundit, **qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë nismash për të përfshirë OJF-të (duke përfshirë këtu dhe OJF në Bashkinë e Kukësit) në procesin e hartimit të politikave.**
- Pavarësisht ndërmarrjeve të këtyre nismave, aktualisht vihet re burime fondesh të reduktuara, gjë që ndikon te OJF-ët në **përcjelljen e zërit të komuniteteve të ndryshme** dhe të kryejnë siç duhet rolin e tyre mbikëqyrës.
- **OJF e përfshira në studim hasin pengesa në ushtrimin e plotë të funksioneve të tyre për të kanalizuar shqetësimet e qytetarëve** në proceset e politikave përmes mekanizmave të duhur të pjesëmarrjes dhe konsultimit të vërtetë.
- **Një risi e dekadave të fundit është konsultimi publik, por ekziston një mungesë e vullnetit politik** për të realizuar procese të vërteta konsultimi dhe për të përmirësuar bashkëpunimin mes OJF-ve dhe institucioneve është evidente. Rrjedhimisht, kjo gjë rrit edhe më shumë mosbesimin e ndërsjellë mes institucioneve publike dhe OJF-ve në lidhje me bashkëpunimin dhe ndikimin e tij.
- Pjesa më e madhe e organizatave kanë **kapacitete të pamjaftueshme dhe mangësi në burime** për të pasur një impakt të rëndësishëm në komunitet.

- Kapaciteti për përfshirje **në analiza të politikave dhe proceseve të dialogut kombëtar** për çështjet mjedisore është vlerësuar “mesatarisht” nga OJF-të e përfshira në studim. OJF-të në Bashkinë Kukësit vlerësuan “deri diku”, **kapacitetet që lidhen me zhvillimin e projekteve, mobilizimin e burimeve, planifikimin e burimeve**. Po ashtu edhe kapacitetet për të monitoruar dhe vlerësuar problemet mjedisore.
- Ndërkohë kapacitetet e OJF-ve për zhvillimin e strategjive, politikave dhe legjislacionit **në lidhje me menaxhimin e mjedisit janë të pakta**.
- Institucionet qeveritare, megjithëse janë të mandatuara për të përfshirë publikun e gjerë në vendimmarrje, **rrallë shndërrojnë rekomandimet e shoqërisë civile** në politika në një mënyrë adekuate.

5.2 Rekomandime

- **Bashkëpunimi i vazhdueshëm midis OJF-ve mjedisore dhe vendimmarrësve do të jetë thelbësor për të rritur eficienten e projekteve.** Dialogu dhe bashkëpunimi do të sigurojë që rezultatet e projektit të jenë të qëndrueshme dhe do të sigurojnë një platformë për partneritete të suksesshme në të ardhmen
- Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit mes OJF lokale për të fuqizuar ndikimin e tyre në organet vendmarrëse për çështjet mjedisore
- Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit mes OJF-ve Mjedisoret të Bashkisë Kukës dhe OJF Mjedisore të Komunës së Gjakovës, Pejës për nxitur zgjidhjen e problemeve mjedisore ndërkufitare – siç është dhe rast i menaxhimit të prurjeve që sjell Lumi Drin i Bardhë, por dhe çështje mjedisore të tjera
- Rritja e edukimit mjedisor tek të rinjve përmes ndikimit në rritjen e numrit të lëndëve që trajtojnë çështjet mjedisore. Kjo do të realizohet kur IA (Institucioni arsimor, pra shkolla) ofron në kurrikul bazë modul me fokus çështje mjedisor. Aktualisht, moduli “ndryshimet klimatike” ofrohen si kurrikul me zgjedhje në shkollë e mesme të miratuara nga institucionet përgjegjëse. Angazhimi i të rinjve është thelbësor për të nxitur mbrojtjen e mjedisit në të ardhmen. Eko-klubet, përmes promovimit në mediat sociale si dhe kryerja e fushatave ndërgjegjësuese, janë mjete efektive për angazhimin e të rinjve, përhapjen në terren, avokimin dhe ndryshimin e sjelljes, dhe kështu përfaqësojnë mekanizma të fortë për të ndikuar në vendimmarrje.
- Nxitja e aktiviteve ndërgjegjësuese sipas kalendarit ndërkombëtar të ditëve mjedisor. Me qëllim rritjen e edukimit mjedisor dhe reagimit qytetar për problemet që ata i shqetësojnë.
- Krijimi i një fushate të përbashkëta/ aktive ndërgjegjësuese mbi Ndryshimet Klimatike të të rinjve mes Bashkisë Kukës dhe Komunës së Gjakovës. Kjo në përgjigje të nismave të marra nga BE në kuadër të “Emergjencës Klimatike”⁷ dhe dhënie së kontributit të të rinjve në zgjidhje të tyre.

⁷ <https://www.europarl.europa.eu/news/en/press-room/20191121IPR67110/the-european-parliament-declares-climate-emergency>

- **Përdorimi aktiv i rrjeteve sociale dhe platformave të komunikimit është thelbësor për të rritur ndërgjegjësimin tek popullata kryesisht e re.** Duke marrë parasysh që shumica e popullsisë në vend është në moshë të re dhe përdorimi i gjerë i rrjeteve sociale do të ishte një mënyrë efektive për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të përfshirjes së të rinjve në komunitetin në çështjet mjedisore.
- Përtej të gjitha pengesave, shoqëria civile ka të gjitha mundësitë të jetë një aktor i rëndësishëm në vendimmarrje dhe të ndikojë në përcimin e zërit të grupeve të ndryshme të interesit në institucione. **Me zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve dhe hapësirën për të vepruar, OJF-të mund të ndërhyjnë për të ndihmuar në ofrimin e shërbimeve dhe për të mbështetur politikatat e qeverisë.** Rritja e kapaciteteve për përfshirjen e palëve të interesuara në hartimin e politikave arrihet duke krijuar tryezave të rrumbullakëta me aktorë të fushës në mënyrë që OJF-te bashkëpunojnë më institucionet qeveritare për përcaktimin e axhendës së konsultimeve dhe proceseve të zhvillimit të politikave për menaxhimin e mjedisit.

Bibliografia

- Ligji i ri nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave"[\[link ligji\]](#)
- Menaxhimi i Burimeve Natyrore në Evropën Juglindore: Pyjet, Toka dhe Ujërat (2017), Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH [\[link\]](#)
- Plani i përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kukës (2017), [\[link\]](#)
- Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 73 datë 7.2.2018 [\[link\]](#)
- Strategjinë Kombëtare e Sektorit Furzimit me Ujë dhe Kanalizimeve për 2020-2030, Ministria e Infrstrukturës dhe Energjisë, [\[link\]](#)
- She-Era dhe ACER (2020) Raportet Narrative te projektit “Ujë të Pastër në Gjakovë dhe Kukës”
- The European Parliament declares climate emergency, Press Releases (2019), [\[link\]](#)

Shtojca 2: Lista e OJF Kukes

Nr.	Emri i OJF-së	Vendi	Person Kontakti	Telefon	E-mail
1.	Agjencia e Zhvillimit Rajonal	Kukës	Arjola Domi	672738945	rdakukes@gmail.com ;
2.	ALB-AID	Kukës	Jonuz Kola	024224006	
3.	Federata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale (FPPKK)	Kukës	Xhelal Shuti	692371753	fedkuk@yahoo.com ;
4.	Qendra Integrim e Zhvillim Demokratik Kukës (QIZHDK)	Kukës	Zyrjan Alushi	0692097016; 0672018016	zyrjanalushi@yahoo.com ;
5.	Qendra për Progres Rinor	Kukës	Lavdrim Shehu	682095148	orgcyp@hotmail.com ;
6.	Rinia në Sipërmarrjen e Lirë	Kukës	Rifat Demalija	024223113;	rslog@hotmail.com ; orgsl@yahoo.com ;
7.	Shoqata Integrimi	Kukës	Xhevdet Hoxha;	0692072920;	integrimda@yahoo.com ;
8.	Shoqata Mjedisore "ALPIN"	Kukës	Astrit Metaliaj	682404490;	alpin_m@yahoo.com / ametaliaj@hotmail.com ;
9.	DMO-Kukes (Organizata e Menaxhimit të Destinacionit Turistik Kukës)	Kukës			
10.	Keshilli Rinor Rajonal Kukes	Kukës	Merita Hoxha	693084637	keshillikrrk@gmail.com ; krrk@yahoo.com
11.	Shoqata Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit	Kukës	Jahir Cahani	685584931	mbrojtjamjedisit@yahoo.com
12.	Organizata e Menaxhimit te Peshkimit Kukes	Kukës	Besart Halilaj	068 625 6566	besihalilaj@hotmail.com
13.	Green peace albania	Kukës	Oljora Zoto	066 554 4590	
14.	Shoqata Biznesi per Biznesin	Kukës	Sokol Kolgjini	068 201 3297	biznesiperbiznesin@gmail.com
15.	Agjencia e Zhvillimit Rajonal Rural Kukes	Kukës	Vexhi Halili	068 232 4515	
16.	Federata e Fermereve Kukes	Kukës	Kadri Bulica	068 401 2673	
17.	Observatori për të drejtat e fëmijëve, kukës	Kukës	Shkelqim Muça	00355 67 27 86 298	kukes@observator.org.al
18.	SHOQATA kombëtare e shëndetësisë shqiptare	Kukës	Azem Brasha;	0242 2655	gj_cahani@yahoo.com ;
19.	Shoqata për Kulturë Demokratike, Kukës	Kukës	Ylber Cejku	069 2094196	ylbercejku@yahoo.com ;
20.	Ekologet per Rajonin Kukes	Kukës	Bukurosh Onuzi	692096645	buabon@yahoo.com ;
21.	LAG	Kukës			lag.korabkoretnik@gmail.com

Shtojca 3: Instrumenti vetëvlerësues

Emri i Organizatës që përfaqësoni:

Vlerësoni nga 1 te 5

		1. Shumë Pak	2. Pak	3. Mesatarisht	4. Deri diku	5. Shumë
1.	Kapaciteti për përfshirje në analiza të politikave dhe proceseve të dialogut kombëtar ose nën-kombëtar, në lidhje me qeverisjen dhe menaxhimin e mjedisit.					
2.	Kapacitetet për të gjeneruar, aksesuar dhe përdorur informacion dhe rritje njohurish					
3.	Kapacitetet për zhvillimin e strategjisë, politikave dhe legjislacionit në menaxhimin e mjedisit					
4.	Kapacitetet për menaxhim dhe implementim (zhvillimin e projekteve, mobilizimin e burimeve, planifikimin e burimeve)					
5.	Kapacitetet për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimet dhe trendet mjedisore					

Në bazë të projekteve/ studimeve që ju keni marrë në kuadër të mjedisit, ju lutem listoni:

Pengesat⁸ me të cilat ju si OJF përballeni, në zhvillimin e projekteve apo rritjen e kapaciteteve:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

Ndikimet/ Impakti dhe arritjet e OJF:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

Mësimet e nxjerra nga projektet/ studimet e zhvilluara:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

⁸ Mund të jenë më shumë se 5.